



Nr. Ref. BD-220/101

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale: 00914-0 me sipërfaqe të përgjithshme 4807 m² dhe 00915-0 me sipërfaqe të përgjithshme 4567 m², ZK Rastavicë, komuna Deçan, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Ereniku me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Ereniku me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij dy ngastrat e cekura në dispozitiv të këtij vendimi kufizohen me ngastrën e familjes së tij nr. 976-3 dhe të njëjtat dëshiron ti bashkojë.

Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur ekspertizën gjeodezike duke elaboruar dhe përshkruar pretendimet e tij lidhur me ngastrën në fjalë. Sipas ekspertizës ngastrat në anën veri perëndimore kufizohen me parcelën 976-3 e cila në regjistrat kadastral evidentohet në emër të

ndërsa në pjesën lindore me _____ përderisa në anën veriore dhe jugore kufizohet me parcelën e NSh-së si dhe në pjesën verilindore me pronën e ndërmarrjes "PSh Rrugët". Parcelat kadastrale të cilat janë objekt i kërkesës gjenden në zonën kadastrale Rastavicë në Komunën e Deçanit dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme, si bujqësore e po ashtu edhe biznesi me aktivitete të ndryshme dhe të njëjtat kanë një sipërfaqe të madhe prej 0.93 ha.

Në këto parcela, sipas ekspertizës pamjeve të gjeoportalit, shihet se nuk ka ndërtim derisa qasjen në rrugë e kanë në pjesën verilindore të ngastrës 915-0.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se dëshiron ti bashkojë me ngastrat e tij dhe duke pas parasysh faktin që ngastra ka qasje në rrugë dhe nuk ka ndërtim.. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/102

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 5917 m², pjesë e parcelës kadastrale P. Nr.409-0 me sipërfaqe të përgjithshme 11776 m², ZK Trepeticë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij këtë pronë e ka në shfrytëzim që nga viti 2000 dhe të njëjtën e ka në shfrytëzim si tokë bujqësore dhe në të ka ndërtuar një shtëpi banimi.

Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike dhe të cilat janë marrë nga ZKK në Prizren parcela 409-0 ZK Trepeticë evidentohet si parcelë tokësore e klasit të tretë dhe jo pjellore në sipërfaqe prej 11776m² në emër të KBI Progres, Prizren. Parcela gjendet në ZK Trepeticë - Prizren dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme bujqësore. Në pronë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit ka qasje të pa penguar në rrugë publike.

Sa i përket ndërtimit të përmendur nga ana e palës, i njëjti është ndërtuar pas vitit 2018 dhe aktualisht nuk shihet në ortofotot e gjeoportalit as të vitit 2018 dhe as të vitit 2024 dhe kjo është në kundërshtim me paragrafin 1.1.2 i Rregullores nr.04/2024 për shitjen direkte të asetëve të caktuara të NSH-ve i cili ndër të tjera thekson se: *...Ndërtimet e realizuara, të cilat nuk janë të dukshme në aero incizimet e vitit 2018, kur në territorin e Republikës së Kosovës është zbatuar incizimi i fundit aerofotogrametrik, nuk do të përfshihen në proces të shitjes direkte.*


Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se është shfrytëzues i ngastrës dhe duke pas parasysh faktin që ngastra ka qasje në rrugë dhe ka ndërtim por në kundërshtim me nenin 1.1.2 të Rregullores, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/103

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale: 01330-0 me sipërfaqe të përgjithshme 27729 m² dhe 01329-0, me sipërfaqe të përgjithshme 385 m², ZK Stubëll e Epërme, komuna Viti, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore Agromorava në Viti, me parashtruesen

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Agromorava në Viti, me parashtruesen

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së saj me qëllim për të shfrytëzuar si një bahçe dhe një park për gastronomi. Në kërkesë nuk është dhënë asnjë arsyetim apo përshkrim tjetër lidhur me këtë pretendim. Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur ndonjë ekspertizë gjeodezike për t'i elaboruar me saktësi pretendimet e saj, përveç se ka bashkangjitur ortofoto nga gjeoportali i Kosovës si dhe kopjen e planit lidhur me këto ngastra.


Parcelat gjenden në zonën kadastrale Stubëll e Epërme në Komunën e Vitisë dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme, si bujqësore po ashtu edhe biznesi me aktivitete të ndryshme dhe të njëjtat kanë sipërfaqe të madhe, prej 2.7 ha e që gjenden pothuajse në mesin e fshatit Stubëll.

Parcelat kanë qasje në rrugë, në fakt rruga e emëruar "Anton Çetta" kalon nëpër këto ngastra dhe shihet se ka disa ndërtime mirëpo nuk janë në posedim apo shfrytëzim të parashtrueses së kërkesës.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin dëshiron të shfrytëzoj si një bahçe dhe një park për gastronomi dhe duke pas parasysh faktin që ngastrat kanë qasje në rrugë, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/104

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 3471 m², pjesë e parcelës kadastrale nr. 05158-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 8100 m², ZK Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, Prizren, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, Prizren, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij qysh nga paslufta e ka në shfrytëzim këtë parcelë dhe të njëjtën e ka në shfrytëzim edhe tani si tokë bujqësore.

Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike dhe të cilat janë marrë nga ZKK Prizren, parcela 05158-0 ZK në Prizren evidentohet si parcelë tokësore me kulturë arë e klasit të katërt me sipërfaqe prej 8100m² në vendin e quajtur Kamenica dhe evidentohet në emër të KBI Progres Prizren e cila është në bashkëpronësi në 3/7 me:)2/7 dhe 2/7. Parcela

gjendet në ZK Prizren dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme, po ashtu edhe ato bujqësore. Në pronë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe e njëjta ka qasje në rrugë.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se e ka në shfrytëzim dhe duke pas parasysh faktin që ngastra ka qasje në rrugë dhe nuk ka ndërtim, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/105

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.00110-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 5898 m², ZK Dushanovë, pronë e NSh KBI Progres, Prizren, me parashtruesin
- II. ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, Prizren, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij qysh nga paslufta e ka në shfrytëzim këtë parcelë dhe të njëjtën e ka në shfrytëzim edhe tani si tokë bujqësore.

Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike dhe të cilat janë marrë nga ZKK Prizren në parcela nr. 00110-0 ZK Dushanovë evidentohet si parcelë tokësore me kulturë arë e klasit të pestë me sipërfaqe prej 8100m² në vendim e quajtur "Barutni Magacin Puta" dhe evidentohet në emër të KBI Progres, Prizren Parcela gjendet në ZK Dushanovë në Komunën e Prizrenit dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë e ndryshme, po ashtu edhe ato bujqësore. Në pronë aktualisht nuk ka ndonjë ndërtim dhe e njëjta ka qasje në rrugë.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se e ka në shfrytëzim dhe duke pas parasysh faktin që ngastra ka qasje në rrugë dhe nuk ka ndërtim, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/106

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr.01330-0 me sipërfaqe të përgjithshme 27729 m2 ZK, Stubëll e Epërme, pronë e NSh Agromorava në Viti, me parashtruesen
- II. ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Agromorava në Viti, me parashtruesen

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së saj ta blej pjesën e cila është përpara parcelave të saj dhe vëllait të saj

dhe si rrjedhojë kërkon një pjesë të kësaj ngastrë (pa specifikuar saktë cilën pjesë) ta privatizoj në drejtim të parcelave të tij sepse dëshiron ti mbjellë me fidane dhe pemë të ndryshme.

Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur ndonjë ekspertizë gjeodezike për të elaboruar me saktësi pretendimet e tij, përveç se ka bashkangjitur ortofoto nga gjeoportali i Kosovës si dhe kopjen e planit lidhur me këto ngastra. Parcela gjendet në ZK Stubëll e Epërme në Komunën e Vitisë dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme, si bujqësore e po ashtu edhe biznesi me aktivitete të ndryshme dhe e njëjta ka një sipërfaqe të madhe prej 2.7 ha e cila gjendet pothuajse në mesin e fshatit Stubëll.


Parcela ka qasje nëpër rrugë, në fakt rruga e emëruar "Anton Çeta" kalon në këtë ngastër dhe në të shihet se ka disa ndërtime mirëpo nuk janë në posedim apo shfrytëzim të parashtruesit të kërkesës.


Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se dëshiron ta bashkojë me parcelat e tij dhe të mbjellë fidanë dhe pemë të ndryshme dhe duke pas parasysh faktin që ngastra ka qasje në rrugë dhe nuk ka ndërtim, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/107

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale 00279-0 me sipërfaqe të përgjithshme 7132 m², ZK Talinoc i Muhaxherëve, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Pasuria Bujqësore" Ferizaj, me parashtruesin
- II. ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh "Pasuria Bujqësore" Ferizaj, me parashtruesin


Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij ngastrën kërkon ta blejë përmes shitjes direkte, duke se në pjesën lindore kufizohet me ngastrën 278-0 si dhe në pjesën perëndimore me ngastrën 280-0 të cilat janë pronë private e parashtruesit të kërkesës, përderisa në pjesën jugore dhe veriore kjo ngastër kufizohet me rrugë publike.

Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur edhe ekspertizën gjeodezike për ta elaboruar dhe përshkruar kërkesën e tij në raport me ngastrën 279-0 si dhe ka bashkangjitur ortofoto nga gjeoportali i Kosovës si dhe kopjen e planit lidhur me këto ngastra. Ngastra gjendet në ZK Talinoc i Muhaxhereve Ferizaj dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme si bujqësore dhe po ashtu edhe biznesi me aktivitete të ndryshme biznesi. Ngastra ka qasje nëpër rrugë në të dy anët e saj si dhe nuk ka ndërtim, Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se dëshiron ta bashkoj kufizohet në dy anë me pronën e tij dhe duke pas parasysh faktin që ngastra ka qasje në rrugë në dy anët tjera dhe nuk ka ndërtim, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/108

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale 00839-2 me sipërfaqe të përgjithshme 4682.8 m², ZK Talinoc i Muhaxherëve, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Pasuria Bujqësore" Ferizaj, me parashtruesin
- II. ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh "Pasuria Bujqësore" Ferizaj, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij ngastra e cekur në dispozitiv të këtij vendimi kufizohet me ngastrën 840-0 ZK Talinoc i Muhaxherëve e cila është pronë private e parashtruese së kërkesës. Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur edhe ekspertizën gjeodezike për të elaboruar dhe përshkruar kërkesën e saj në raport me ngastrën 00839-2 si dhe ka bashkangjitur ortofoto nga gjeoportali i Kosovës si dhe kopjen e planit lidhur me këtë ngastër e cila gjendet në ZK Talinoc i Muhaxherëve Ferizaj dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme, si bujqësore e po ashtu edhe me aktivitete të ndryshme biznesi.

Në këtë ngastër sipas ekspertizës gjeodezike të dorëzuar nga pala dhe pamjeve të gjeoportalit e njëjta ka qasje në rrugë si dhe nuk ka ndërtim.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se dëshiron ta bashkojë kufizohet me pronën e tij dhe duke pas parasysh faktin që ngastra ka qasje në rrugë dhe nuk ka ndërtim, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025





Nr. Ref. BD-220/109

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 1000 m² pjesë e parcelës kadastrale Nr.00379-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 7664 m², ZK Dushanovë, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres Prizren, me parashtruesin
- II. ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres Prizren, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij ngastrën në fjalë e shfrytëzon duke mos dhënë detaje tjera dhe rrjedhimisht ka shprehur interesimin dhe dëshirën për ta privatizuar të njëjtën. Në mbështetje të kërkesës pala ka dorëzuar edhe ekspertizën gjeodezike përmes së cilës ka elaboruar përmes ortofotos dhe skicës pretendimet e tij lidhur me ngastrën 379-1. Parcela gjendet në ZK Dushanovë Prizren, në një zonë rezidenciale ku ka të ndërtuara edhe shtëpi banimi të tjera. Në pronë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe e njëjta ka qasje në rrugë. Në këtë pronë nuk ka ndërtim dhe e njëjta ka qasje në rrugë,

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se e shfrytëzon dhe duke pas parasysh faktin që ngastra ka qasje në rrugë dhe nuk ka ndërtim, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/110

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale: P. Nr.00394-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2500 m² dhe P. Nr. 00394-2 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1500 m², ZK Bratotin, komuna Rahovec, prona të Ndërmarrjes Shoqërore NBI Rahoveci, me parashtruesin
- II. ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh NBI Rahoveci, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij ngastrat kadastrale 00394-1 dhe 00394-2 janë duke u shfrytëzuar si arë, ku kryesisht janë të mbjellura me kultura sikurse janë: misri, tërshëra, gruri etj.

Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike dhe të cilat janë marrë nga ZKK në Rahovec parcela 00394-1 dhe 00394-2 ZK Bratotin evidentohet si parcelë tokësore e klasit të pestë në vendin e quajtur Arash-Orash dhe atë në emër të P.SH.E KOSOV.KK Rrahovec - Shfrytëzues NBI Rahoveci. Parcelat gjenden në zonën kadastrale në Bratotin në Komunën e Rahovecit dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme bujqësore. Në parcela nuk ka ndonjë ndërtim dhe ngastra 394-2 ka qasje në rrugë përderisa edhe ngastra 394-1 qaset në rrugë përmes ngastrës 394-2.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se e shfrytëzon dhe duke pas parasysh faktin që ngastrat kanë qasje në rrugë dhe nuk ka ndërtim, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/111

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P.Nr .0137-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 35927 m², ZK Bakshi, komuna Obiliq pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KB Liria Bardhosh (ish Devet Jugovic), me parashtruesin

II. ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KB Liria Bardhosh (ish Devet Jugovic), me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij ngastra kadastrale 137-0 me sipërfaqe 3.59 ha është pjesë integrale e kompleksit të pronës private e bashkuar me ngastrën 136-0 e cila është në pronësi të _____ i cili ka ndërruar jetë në vitin 1902 ndërsa trashëgimtar i ngastrës 136-0 është _____, tutje i njëjti ka theksuar se ngastra 137-0 nuk ka dalje në rrugë dhe se e njëjta në të tri anët e rrethon ngastrën 136-0 e cila është në pronësi të parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës është në posedim faktik të ngastrës që nga përfundimi i luftës në Kosovë. Po ashtu i njëjti ka theksuar se nuk e ka ditur se i ati _____ ka lidhur marrëveshje për arondimin ashtu që ngastra 137-0 të kalojë në pronësi të KB Liria për shkak se sipas tij kjo marrëveshje asnjëherë nuk është realizuar në praktikë.

Pala në mbështetje të kërkesës ka dorëzuar edhe ekspertizën gjeodezike ku në të njëjtën është theksuar se ngastra 137-0 nuk ka objekt të ndërtuar mirëpo e tërë ngastra që ka një sipërfaqe prej 3.59HA është duke u shfrytëzuar me të mbjella. Parashtruesi i kërkesës është pronar i ngastrës 136-0 e cila në të tri anët rrethohet me ngastrën 137-0, përderisa qasja në rrugë publike kalon përmes parcelës 303-0 që është pronë e komunës së Obiliqit.

Parcela gjendet në ZK të shatit Bakshi - Komuna e Obiliqit dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme. Në këtë parcelë nuk ka ndonjë ndërtim.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se e shfrytëzon dhe duke pas parasysh faktin që ngastrat kanë qasje në rrugë përmes pronës së Komunës Obiliq dhe nuk ka ndërtim, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/112

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr. 01092-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 16883 m2, ZK Bec, komuna Gjakovë, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore Kooperativa Bujqësore "Bec", me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KB Bec me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij ngastrën në fjalë e ka në shfrytëzim dhe posedim që nga viti 2017 kur e ka marrë me qira nga Agjencia dhe për të njëjtën rregullisht paguan qira vjetore. Pala po ashtu ka theksuar se për këtë ngastër ka vite që kujdeset duke e mbjellë me kultura të ndryshme bujqësore.

Parcela gjendet në ZK Bec - komuna e Gjakovës dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme bujqësore për çka edhe është duke u shfrytëzuar. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe e njëjta ka qasje në rrugë.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se e shfrytëzon me qira nga Agjencia dhe duke pas parasysh faktin që ngastrat kanë qasje në rrugë dhe nuk ka ndërtim, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/113

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 1258 m² pjesë e parcelës kadastrale P. Nr. 00548-20 me sipërfaqe të përgjithshme prej 6638 m², ZK Skenderaj, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore Fabrika e Municionit ne Skenderaj, me parashtruesin
- II. ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSH Fabrika e Municionit ne Skenderaj, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij ngastrën në fjalë e ka në shfrytëzim dhe posedim që nga viti 1986 ndërsa nga viti 2012 e ka marrë me qira nga AKP dhe për të njëjtën rregullisht paguan qira vjetore. Pala po ashtu ka theksuar se gjatë kësaj periudhe kohore ka bërë disa investime, si heqja e dheut, vendosja e zhavorit dhe ndërtimi i murit mbajtës në vlerë afër 50,000 euro.

Parcela gjendet në ZK Skenderaj dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim përveç një muri mbrojtës në parcelë dhe e njëjta ka qasje direkte në rrugë publike.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se e shfrytëzon me qira nga Agjencia dhe duke pas parasysh faktin që ngastra ka qasje në rrugë dhe nuk ka ndërtim, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/114

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 1970 m², pjesë e parcelës kadastrale Nr. 09324-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 3942 m², ZK Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin
- II. ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij qysh para 30 viteve e ka në shfrytëzim për nevoja bujqësore.

Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike dhe të cilat janë marrë nga ZKK Prizren në parcela 9324 ZK Prizren evidentohet si parcelë tokësore me kulturë arrë e klasit të parë me sipërfaqe prej 3942m² në Prizren dhe evidentohet në emër të KBI Progres. Parcela gjendet në ZK në Prizren dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme bujqësore. Në këtë pronë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe e njëjta ka qasje në rrugë.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se e shfrytëzon dhe duke pas parasysh faktin që ngastra ka qasje në rrugë dhe nuk ka ndërtim, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/115

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 1970 m², pjesë e parcelës kadastrale Nr. 09324-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 3942 m², ZK Prizren pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin
- II. ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij qysh para 30 viteve e ka në shfrytëzim këtë parcelë dhe të njëjtën e ka në shfrytëzim për nevoja bujqësore.

Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike dhe të cilat janë marrë nga ZKK Prizren në parcela 9324 ZK Prizren evidentohet si parcelë tokësore me kulturë arë e klasit të parë me sipërfaqe prej 3942m² në vendin e quajtur Prizren dhe evidentohet në emër të KBI Progres Parcela kadastrale e cila është objekt i kërkesës gjendet në zonën kadastrale në Prizren në Komunën e Prizrenit dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtari të ndryshme bujqësore. Në pronë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe e njëjta ka qasje në rrugë.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se e shfrytëzon dhe duke pas parasysh faktin që ngastra ka qasje në rrugë dhe nuk ka ndërtim, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/116

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore 517 m², pjesë e parcelës kadastrale Nr. 00815-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 3680 m², ZK Lubizhdë, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, Prizren, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

